



Pranuar / Dorezuar Punjenor/Prodato Received/Delivered	17-01-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedimca Org./Unit	Nr Prot B: Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM8/HCK	446/2023		118



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.540/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.872/22 të datës 21.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.109/2020 të datës 01.04.2020 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Nr.02/2020 me nr. protokollin 963/2020 i datës 04.03.2020 të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Akt-Njoftimit me numër protokollin 1044/2020 të datës 11.03.2020 për anulimin e konkursit të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.109/2020 e datës 01.04.2020 e parashtruar nga ankuesja

II. **SHFUQIZOHET** Vendimi KZKA Nr.02/2020 i datës 04.03.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe Akt-Njoftimi me numër protokollin 1044/2020 i datës 11.03.2020 i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

III. **MBETET** në fuqi Njoftimi për kandidatin e suksesshëm me numër protokollin 113/2020 i datës 15.01.2020 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

IV. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporti që brenda

afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankueses ti lëshojë Akt Emërimin lidhur pozitivisht e përzgjedhur sipas Njoftimit me numër protokollit 113/2020 i datës 15.01.2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Ankuesja më datë 25.03.2020 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është protokolluar me numër 699/2020 më datë 01.04.2020, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me nr. protokollit 963/2020 i datës 04.03.2020 të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Akt-Njoftimit me numër protokollit 1044/2020 të datës 11.03.2020 për anulimin e konkursit të shpallur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02.04.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ndërsa me datën 17.04.2020 me numër protokollit 745/2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 18.06.2020 me numër protokollit 1187/2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës kompetente.

Ankuesja, ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 07.06.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.868/2020, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 16.06.2021 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.06.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 01.04.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2021 përmes Njoftimit me numër protokollit 3540/21 ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.540/2021 të datës 16.06.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjtën mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesja përsëri ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datën 21.11.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.872/22, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 01.12.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 07.07.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 01.04.2020.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 699/2020 të datës 01.04.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Pliko me numër R7613368 i datës 25.03.2020; Aktgjykim me numër A.nr.872/22 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 21.11.2022 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 01.12.2022; Kërkesë për vendosjen e ankesës e ankueses me numër protokollit 395/2022 e datës 28.01.2022; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 01.03.2022; Kërkesë e përsëritur e datës 01.03.2022; Aktgjykim me numër A.nr.868/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 07.06.2021 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 16.06.2021; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 29.07.2021; Njoftim me numër protokollit 3541/21 i datës 07.07.2021; Njoftim me numër protokollit 3540/21 i datës 07.07.2021; Njoftim me numër protokollit 1187/2020 i datës 18.06.2020; Fletëkthesë e datës 08.07.2021; Fletëkthesë e datës 08.07.2021; Diplomë nga UBT për [redacted] me numër Nr.136/45-64 i datës 11.01.2011; Certifikatë nga Ozel Tekirdag Koleji për [redacted] i datës 20.06.2006; Konkurs nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me numër protokollit 3729/2019-2 i datës 04.09.2019; Njoftim për pezullimin e konkurseve me numër protokollit 4316/2019 i datës 11.10.2019; Njoftim me numër referenc ZSP i datës 09.01.2020; Njoftim për kandidatin e suksesshëm me numër protokollit 113/2020 i datës 15.01.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit me numër protokollit 963/2020 i datës 04.03.2020; CV-ja e [redacted]; Vërtetim nga Elzateks për [redacted] i datës 20.02.2017; Vendim nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për [redacted] me numër protokollit 675/2018 i datës 08.03.2018; Kontratë nga kabineti i Ministrisë për [redacted] me numër protokollit 676/2018 i datës 08.03.2018; Referencë nga Komuna e Prizrenit për [redacted] i datës 10.08.2011; Vendim nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kabineti i Ministrisë për [redacted] me numër protokollit 4594/2017 i datës 06.11.2017; Kontratë nga kabineti i Ministrisë për [redacted] me numër protokollit 4637/2017 i datës 09.11.2017; Kontratë pune për kohë të caktuar nga Trepharm për [redacted] i datës 15.03.2017; Kontratë Pune nga Barnatorja e Qytetit për [redacted] i datës 03.01.2012; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 01.04.2020; E-mail nga [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) për E.S. i datës 30.03.2020; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 30.03.2020; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 17.04.2020; Përgjigje në kërkesë i datës 17.04.2020; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 16.04.2020; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 14.04.2020; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 02.04.2020; Kërkesë për fillimin e rekrutimit (punësimit) e datës 30.08.2019; Autorizim nga MAP i datës 02.09.2019; Konkurs i shpallur në gazetën Bota sot i datës 04.09.2019; Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës me numër protokollit 4045/2019 i datës 23.09.2019; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të [redacted] i datës 20.10.2015; Vendim për [redacted] i datës 24.07.2019; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të [redacted] i datës 14.07.2015; Akt Emërim i [redacted] i datës 19.04.2013; Akt

Emërim i \_\_\_\_\_ i datës 08.11.2018; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të \_\_\_\_\_ i datës 12.01.2015; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 04.09.2019; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë Form.MAP-SHCK-05; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-07a; Lista e ngushtë për intervistë e datës 03.10.2019; Kandidatët e ftuar për test me shkrim i datës 01.10.2019; Njoftim për anulimin e konkursit me numër protokolli 1044/2020 i datës 11.03.2020; E-mail nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ etj. i datës 02.10.2019; E-mail nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ studentit etj. i datës 27.09.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për \_\_\_\_\_; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues Form.MAP-SHCK-11 i datës 03.10.2019; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form.MAP-SHCK-10; Njoftim për kandidatin e suksesshëm me numër protokolli 113/2020 i datës 15.01.2020; Test me shkrim i \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2019; Test me shkrim i \_\_\_\_\_ .Rr i datës 01.10.2019; Test me shkrim i \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2019; Test me shkrim i \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2019; Test me shkrim i \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2019; Test me shkrim i \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2019; Formulari i kërkesës për punësim i \_\_\_\_\_ i datës 13.09.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e \_\_\_\_\_ me numër 1212 i datës 28.03.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e \_\_\_\_\_ me numër 3212 i datës 30.04.2014; Vërtetim për praktiken e kryer të \_\_\_\_\_ i datës 22.01.2014; Letër referencë për \_\_\_\_\_ i datës 18.02.2014; Kontratë pune për mësimdhënës e \_\_\_\_\_ i datës 08.03.2019; Kontratë pune për mësimdhënës e \_\_\_\_\_ i datës 22.02.2016; Kontratë pune për mësimdhënës e \_\_\_\_\_ i datës 28.10.2015; Marrëveshje shërbimi nga OJQ Nevo koncepti për \_\_\_\_\_ i datës 01.03.2019; Marrëveshje shërbimi nga OJQ Nevo koncepti për \_\_\_\_\_ i datës 25.03.2019; Marrëveshje shërbimi nga OJQ Nevo koncepti për \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2018; Marrëveshje shërbimi nga OJQ Nevo koncepti për \_\_\_\_\_ i datës 01.02.2018; Marrëveshje shërbimi nga OJQ Nevo koncepti për \_\_\_\_\_ i datës 01.04.2018; Marrëveshje shërbimi nga OJQ Nevo koncepti për \_\_\_\_\_ i datës 01.09.2017; Formulari i kërkesës për punësim i \_\_\_\_\_ i datës 18.09.2019; Letërnjoftim i \_\_\_\_\_; Tre pharm kushtet e përgjithsme 1/7 faqe; Mirënjohje nga UBT për \_\_\_\_\_ i datës 19.06.2007; Certifikatë nga Ozel Tekirdag Koleji për \_\_\_\_\_ e vitit 2006; Certifikatë nga BISS për \_\_\_\_\_ i datës 20.07.2003; Certifikatë e gjuhes angleze për \_\_\_\_\_ i datës 29.01.2001; Certifikatë e gjuhes angleze për \_\_\_\_\_ i datës 01.05.2002; E-mail nga \_\_\_\_\_ për [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) i datës 27.12.2022; Dëshmi nga Trusti për \_\_\_\_\_ prej datës 31.05.2017 deri 21.12.2022; Formulari i kërkesës për punësim i \_\_\_\_\_

i datës 16.09.2019; Letërnjoftim i , Diplomë nga Kolegji AAB për . me numër 1198/14 i datës 02.10.2014; Diplomë nga Kolegji AAB për me numër 256/17 i datës 22.03.2017; Vërtetim punësimi i e muajit dhjetor 2008; Mirenjohje për e vitit 2012; Certifikatë nga eulex për e vitit 2009; Letër referencë për i datës 25.11.2002; Diplomë e shkolles së mesme për e datës 13.06.1995; Letër referencë nga kolegji AAB për ; Shkresë nga Unmik për i datës 15.04.2010; Certifikatë nga eulex për e datës 12.12.2017; Ankesë e datës 03.02.2020 nga . ; Shkresë nga posta Koex e datës 18.09.2019; Letër Referencë nga AAB për i datës 11.03.2019; Certifikatë nga eulex për e vitit 2009; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për me numër 267 i datës 22.03.2006; Certifikatë nga eulex për e vitit 2016; Certifikatë për i datës 12.07.2019; Certifikatë nga eulex për B.Sh. e vitit 2018; Raporti i vlerësimit të performances nga eulex për i datës 11.12.2018;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët duke vlerësuar kompetencën lëndore dhe lejueshmërinë e ankesës, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 02.09.2019, ka shpallur me datë 04.09.2019 Konkursin me numër reference 57/2019 për pozitën "Zyrtar i Lartë i Promovimit" në Departamentin e Kulturës në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se sipas konkursit me numër reference 57/2019 për pozitën "Zyrtar i Lartë i Promovimit", në Departamentin e Kulturës në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, si kritere të pranimit janë përcaktuar: **Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale: Diplomë Universitare-drejtimi, juridik, edukim, shkenca politike, Diplomë nga fusha e kulturës dhe e Artit , minimum tri (3) vite përvojë pune profesionale.**

Kolegji, ka vlerësuar në tërësi procedurën e rekrutimit si dhe vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të MKRS me nr. 02/2022 të datës 04.03.2020, si dhe pretendimet e ankueses lidhur me anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar i Lartë i Promovimit".

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht në autorizimin e dhënë nga ana e DASHC/MAP (të siguruar sipas kërkesës së KPMSHCK-së) konstatohet se Udhëheqësi i Personelit ka aprovuar kërkesën për fillim të procedurave të rekrutimit me datë 28.08.2019 ndërsa Zyrtari Kryesor Administrativ ka aprovuar këtë procedurë me datë 29.08.2019, , ndërsa aprovimi nga ana e Departamentit për Administrim të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike është bërë me datë 02.09.2019. Pas marrjes së autorizimit nga organi kompetent MKRS ka shpallur konkursin në gazetën "Bota Sot" me datë 04.09.2019, e tëra është bërë në kuadër të afateve ligjore lidhur me shpalljen e konkursit të lartshënuar. Prandaj me asnjë fakt nuk qëndron e dhëna e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave se konkursi është shpallur para se të merret autorizimi nga DASHC/MAP.

Pas publikimit të konkursit në mjetet e informimit Njësia e personelit ka vepruar konform dispozitës ligjore të nenit 7 paragrafit 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *"Menaxheri i personelit institucionit rekrutues i propozon anëtarët e KPSHC-së, Udhëheqësi më të Lartë Administrativ, me vendim i emëron anëtarët e KPSHC-së dhe e cakton kryesuesin..."*, prandaj në përputhje me këtë dispozitë Udhëheqësi i Personelit ka propozuar përbërjen e Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil, me kërkesën e protokolluar me numër 3777/2020 të datës 05.09.2019 drejtuar tek Udhëheqësi më i Lartë Administrativ respektivisht Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, i cili me datë 20.09.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.1712/2019 i protokolluar me numër 4045/2019 të datës 23.09.2019.

Me datë: 07.10.2019 kjo procedurë e rekrutimit është pezulluar sipas njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike si Ministri përgjegjës për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, deri në momentin e pezullimit sipas njoftimit të lartshënuar MKRS lidhur me pozitën "Zyrtar i Lartë për Promovim" kishte përfunduar edhe intervistimin me gojë gjegjësisht intervistimi ishte mbajtur me datë 03.10.2019, më tutje sipas njoftimit të datës 09.01.2020 nga Ministria e Administratës Publike për vazhdimin e procedurave të rekrutimit sipas Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës. MKRS ka bërë njoftimin përfundimtar për konkursin në fjalë me datë 15.01.2020 kështu që ankuesja ka qenë e përzgjedhur si kandidate fituese sipas njoftimit me nr. 57/2019.

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka vlerësuar kriteret formale të parapara në konkurs dhe ka konstatuar se ankuesja ka plotësuar kriteret e parapara në konkurs, si vijon posedon: Diplomë e studimeve themelore Universitare nga UBT, Baçelor i Arteve në Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci e me numër Nr.136/45-64 i datës 11.01.2011, Certifikatë nga Ozel Tekirdag Koleji për e vitit 2006; Vendim nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për e emëruar Asistente Ekzekutive e Ministrit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit me numër protokolli 675/2018 e datës 08.03.2018; Vendim nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit Kabineti i Ministrit për e emëruar Asistente Administrative e Ministrit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit me numër protokolli 4594/2017 e datës 06.11.2017; Kontratë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit Kabineti i Ministrit për Asistente Administrative e Ministrit me numër protokolli 4637/2017 e datës 09.11.2017; Vërtetim nga "Elzateks" e punësuar në pozitën e administtores së biznesit për prej datës 05.01.2016 deri 31.12.2016, Referencë nga Komuna e Prizrenit e angazhuar në cilësinë e praktikantes në Administratën Komunale të Prizrenit për i datës 10.08.2011, Kontratë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit Kabineti i Ministrit për Asistente Ekzekutive e Ministrit me numër protokolli 676/2018 i datës 08.03.2018, Kontratë Pune nga Barnatorja e Qytetit për prej datës 03.01.2012 deri 31.12.2012, Kontratë Pune për Kohë të Caktuar nga TrePharm për e datës 15.03.2017, Mirënjohje nga UBT për i datës 19.06.2007, Certifikatë nga Ozel Tekirdag Koleji për e vitit 2006, Crtifikatë nga BISS për e datës 20.07.2003; Certifikatë e gjuhës angleze për e datës 29.01.2001, Certifikatë e gjuhës angleze për e datës 01.05.2002, Dëshmi nga Trusti për prej datës 31.05.2017 deri 21.12.2022 si rrjedhojë bazuar në këto dëshmi Kolegji i Këshillit, konstaton që ankuesja ka plotësuar kushtet e konkursit si ato të përgatitjes profesionale po ashtu edhe kushtet lidhur me përvojën e punës, në këtë kuptim

Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes së saj në listë të ngushtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: 1.1.arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe 1.2 përvoja e punës”*.

Kolegji i Këshillit ka analizuar me kujdes Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me nr.02/2020 të datës 04.03.2020 dhe ka konstatuar se nuk qëndron konstatime se konkursi është shpallur në kundërshtim me procedurat ligjore, në shkresat e lëndës të dërguar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk mund të verifikohen dhe as të argumentohen konstatimet e KZKA të MKRS se konkursi është shpallur jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi siç është sqaruar më lartë. Gjithashtu KZKA në vendimin me nr.02/2020 konstaton se janë tejkualuar procedurat ligjore lidhur me përmbylljen e në tersi të aftëve të konkursit, por nuk merr parasysh shkresën e datës 07.10.2019 kjo procedurë e rekrutimit është pezulluar sipas njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike si Ministri përgjegjëse për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe njoftimin e datës 09.01.2020 nga Ministria e Administratës Publike për vazhdimin e procedurave të rekrutimit sipas Ligjit nr.03/L149 për Shërbimin Civil të Kosovës, prandaj ngase u tha Kolegji konstaton se ky Vendim është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse arsytimi i këtij vendimi është i pa bazë dhe në kundërshtim të plotë me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”* dhe nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative...është në kundërshtim me ligjin material”* prandaj mbi këtë bazë pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Bazuar në të gjitha të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që në bazë të Formularit të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me gjithsejtë 85.85 pikë, andaj në shërbimin emërohen kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*, po ashtu Kolegji, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën *“Zyrtar i Lartë i Promovimit”*, në Departamentin e Kulturës në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe se pretendimet e ankueses janë të bazuara, lidhur me

faktin se ka qenë kandidate me më shumë pikë të arritura nga kjo procedurë e zhvilluar sipas dispozitave në fuqi, të cekura si më lartë.


Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit janë të obliguar të ndërmarrin veprimet në pajtim me këtë vendim dhe të bëjnë lëshimin e Akt Emërimit për ankuesen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.540/2021

Rushit Kajtazi  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MKRS
- Arkivit të KPMSHCK-së